

Intervistë ekskluzive për "AMC Press" me z. Rejhan Neziri, imam i rregullt, ligjërues dhe mësues fetar në Bashkësinë Islame Shqiptare "Hëna e re" në Kreuzlingen të Zvicrës

Neziri: "Shikuar nga aspekti fetar nuk ka ndonjë pengesë që kufomat tona të varrosen edhe në Zvicër"

AMC Press: I nderuar z. Neziri, ju jeni teolog i fesë islame dhe këtë profesion e praktikoni në Zvicër në mesin e bashkëkombësve tanë. A mund të informohemi, se si ndjeheni në mesin e mërgimtarëve?

R. Neziri: Po është e vërtetë se që 6 vjet e gjysmë jam i angazhuar në Bashkësinë Islame Shqiptare "Hëna e re" në Kreuzlingen të Zvicrës si imam i rregullt, ligjërues dhe mësues fetar. Para se të vija për herë të parë në Zvicër, sidomos derisa isha në studime në Turqi, as që më shkonte ndërmend të dilja në gurbet, ngase mendoja se duhej të shërbeja në mesin e popullit të cilit i takoja. Deshi Zoti dhe dola këtu në Zvicër vetëm për muajin Ramazan. Ishte ky viti 2000, sapo kisha mbaruar studimet e magjistraturës. Kur erdha këtu, ta them të drejtën, u fascinova me numrin e madh të bashkëkombësve tanë që kishin ardhur me vite përpara ketej e në veçanti më magjepsi struktura jo e zakonitë të ne e xhamiat, pra njerëzve që e vizitojnë xhaminë. Shumicën e përbënin të rinjtë, mezi gjeje ndonjë të thyer në moshë. Pra, diçka e kundërt me realitetin e vendlindjes. Aq më tepër më bënte kënaqësi edhe laramania e viseve prej nga vinin këta mërgimtarë shqiptarë. Dialekte e të folme të ndryshme, adete e zakone të ndryshme, shaka e mahi nga më të ndryshmet i gjen nëpër xhamitë apo qendrat islame shqiptare këtu.

AMC Press: A do ishte më mirë që të predikoni në atdhe apo në diasporë?

R. Neziri: Prej nesh si imamë kërkohet të predikojmë kudo që të jemi, mirëpo predikimi dhe angazhimi profesional këtu në Perëndim ka një rëndësi dhe urgjencë më të madhe sesa në vendlindje, ku me shekuj të tërë feja islame praktikohet brez pas brezi dhe ku është folur e predikuar po aq gjatë nga ana e teologëve muslimanë. Them se ka një rëndësi më të madhe dhe më urgjente, ngase sidomos gjeneratat më të reja ndeshen me rrezikun e asimilimit gjuhësor, kombëtar, fetar e kulturor në mesin e popullatës shumicë që ka një gjuhë, komb, fe e kulturë tjetër nga tonat. Ky rrezik sa vjen prej takimeve spontane e të zakon-



Teologë të shumtë të të gjitha hapësirave shqiptare e kanë vizituar xhaminë në Kreuzlingen, në mesin e tyre edhe kryetari i BI të Kosovës, z.Naim Tërnavaj

ta mes njerëzve, po aq vjen edhe nga qarqe të caktuara që punojnë për këtë, disa prej tyre nën moton e "integritit" dhe "përshtatjes". Për këtë arsye, themelimi apo hapja e xhamive dhe qendrave të ndryshme islame këtu në Zvicër në veçanti dhe në Perëndim në përgjithësi, ka luajtur dhe mëton që edhe më energjikisht në të ardhmen të luajë rolin e ruajtjes dhe kultivimit të vlerave fetare, kombëtare, kulturore etj. Këtë në njëfarë mase e kanë arritur, mirëpo duhet angazhim edhe më i sofistikuar dhe më gjithëpërfshirës duke kërkuar bashkëpunim me organizata e shoqata të tjera shqiptare që punojnë e angazhohen sinqerisht për këto vlera që i përmenda.

AMC Press: Për çka interesohen bashkatdhetarët tanë më shumë gjatë takimeve me ju?

R. Neziri: Nevojat e tyre janë të ndryshme, mirëpo ata, vetëkuptohet, më së shumti interesohen për çështje të fesë si për formën e namazit, përshtatjen e kohëve të tyre me orarin e punës, pastaj për tema familjare që lidhen drejtpërdrejtë me Islamit si fejesa, martesat, synetia etj. Kohëve të fundit është shtuar dukshëm interesimi i tyre rreth sistemit ekonomik të Islamit dhe për mundësinë e shfrytëzimit të mundësive ekonomike të këtij vendi ku gjendemi për një gjallërim të jetës ekonomike të tyre, siç janë për shembull kreditë, sigurimet, bursa etj.

AMC Press: Në xhaminë që

Zvicër.

Në Zvicër ekzistojnë mbi 55 xhami apo qendra islame shqiptare

AMC Press: Cili është bashkëpunimi juaj me xhamitë tjera shqiptare në Zvicër, që nuk janë të pakta?

R. Neziri: Po, në Zvicër ekzistojnë mbi 55 xhami apo qendra islame shqiptare. Një pjesë prej tyre, afro 20 sosh, kanë të punësuar nga një imam të rregullt, disa prej tyre kanë të punësuar vetëm për të premtë e fundjavë e disa sosh ftojnë imamë nga vendlindja vetëm për muajin e Ramazanit. Bashkëpunimi mes tyre, për fat të keq, nuk është i lakmueshëm. Ekziston një bashkëpunim mes xhamive fqinje dhe mes atyre që veten e quajnë se i takojnë këtij apo atij shteti, kësaj apo asaj Bashkësie Islame të vendlindjes, këtij apo atij lokaliteti. Kjo është e mjerueshme... Një arsye shtesë për mungesën e bashkëpunimit të xhamive shqiptare është edhe pavarësia e tyre juridike dhe financiare prej njëra-tjetrës. Secila prej tyre, që vetëkuptohet nga fakti se secila prej tyre quhet "Bashkësi" islame, nuk e sheh veten të lidhur për tjetrën dhe nuk sheh të ketë ndonjë përgjegjësi ndaj xhamive simotra. Edhe ai bashkëpunim i vogël më së shumti vërehet në raste të ditëve apo netëve të mëdha të bekuara kur organizohet ndonjë tribunë shkencore-fetare, kur përfundon cikli i ndonjë shkalle të mësimi fetar nëpër mektebet e xhamive dhe pak më gjallë vjen në



Pamje nga objekti i Bashkësisë Islame Shqiptare "Hëna e re" në Kreuzlingen të Zvicrës

shprehje gjatë muajit të bekuar të Ramazanit...

AMC Press: Duket se është një thyerje e bashkëpunimit mes Bashkësisë Islame të Kosovës dhe asaj të Maqedonisë këtu në Zvicër?

R. Neziri: Kjo thyerje që po e përmendni ju midis këtyre Bashkësive Fetare Islame para së gjithash është e pranishme në vendlindje e prej andej pastaj reflektohet edhe kënde. Secila prej tyre, nga aspekti i vet, mëton të ketë të drejtë juridike dhe financiare mbi shumicën e xhamive apo qendrave islame. E potencoj aspektin financiar, ngase secila prej tyre pret më shumë mjete të këtilla që mblihdhen nga

R. Neziri: Bashkëpunimi ynë si imamë më shumë vërehet në organizimin e ceremonive apo takimeve fetare të xhemateve të ndryshme me rast të festave islame dhe të Ramazanit. Pastaj takimi një herë në vit për organizimin e shtypjes së imsakijeve e kalendarëve islamë... dhe kaq!

AMC Press: Jeni aktivë edhe në organizime të ndryshme në të mirë të përgjithshme në diasporë, sipas Jush, sa po përkrahen aktivitetet e mira në diasporë nga qeveria e Kosovës apo ajo e Maqedonisë?

R. Neziri: Ka kohë që jam në kontakt dhe bashkëpunim me degën e LAPSH-it (Lidhja e Arsimitarëve

vendlindje. Përfashtim bëjnë disa foshnja apo fëmijë të vegjël, të cilët janë varrosur, konkretisht në varrezat publike të qytetit të Kreuzlingenit ku jam unë. Varrimi është bërë sipas rregullave e rendit të varrezave, e jo sipas rregullave që i parashihet Islami, pra që varrezat të mos jenë të përziera dhe të jenë të kthyer drejt Mekkes.

Ne si muslimanë para së gjithash jemi mirënjohës për garantimin e të drejtës së besimit e të ushtrimit të këtij besimi nëpër faltoret tona këtu në Zvicër

AMC Press: Cili është bashkëpunimi juaj me shtetin mik zviceran?

R. Neziri: Ky bashkëpunim shihet në kujdesin e dyanshëm për krijimin dhe ruajtjen e sigurisë, të mirëqenies e të bashkëjetesës, në ruajtjen e ambientit, në krijimin e kushteve për një integritet më të shëndoshë e me më pak dhimbje në shoqërinë ku jetojmë... Nga ana tjetër, është për t'u lavdëruar e për të shprehur mirënjohjet tona më të thella për angazhimin e shtetit zviceran kundruall çështjes shqiptare dhe sidomos çështjes së Kosovës, si në aspektin politik ashtu edhe në atë ekonomik, shëndetësor, arsimor, teknologjik etj. Ne si muslimanë para së gjithash jemi mirënjohës për garantimin e të drejtës së besimit e të ushtrimit të këtij besimi nëpër faltoret tona këtu në Zvicër.

AMC Press: Po keni bashkëpunim me teologët e fesë katolike shqiptare këtu në Zvicër?

R. Neziri: Në rrethin ku jetoj unë nuk kam dëgjuar të ketë ndonjë prift katolik shqiptar, përpos në Sirmach afër Wilit, që është në distancë relativisht e konsiderueshme për takime. Besoj që me të të ketë marrë kontakt e të ketë bashkëpunuar kolegu im në Wil, Bekim ef. Alimi. Unë personalisht kam kontakt me priftin (diakonin) katolik dhe me teologe katolike dhe evangjelistë të Kreuzlingenit me të cilët mundohemi të kultivojmë një atmosferë të mirë të jetesës multi-religjioze. Kështu më 8 maj 2009, për herë të parë këtu në Kreuzlingen u organizua një kremte e përbashkët ndërfaqetare në përkujtim të fëmijëve që kanë përjetuar një vdekje perinatale dhe të atyre që kanë ndërruar jetë në vitet e para të fëmijërisë. Kjo la mbresa të papërshkrueshme si te prindërit muslimanë ashtu edhe tek ata të krishterë, katolikë e evangjelistë. Kjo kremte do të organizohet për çdo vit në të njëjtën datë, një ditë para ditës ndërkombe-tare të nënës. Në plan për realizim janë edhe disa projekte të tjera, si futja e mësimit fetar islam nëpër shkollat publike, një diskutim pub-

lik kundër iniciativës për pengimin e ngritjes së minareve këtu në Zvicër...

AMC Press: Si e shihni rininë e diasporës këtu në Zvicër?

R. Neziri: Është për t'u gëzuar se pjesa dërmuese e tyre kanë së paku nga një zanat, një pjesë e vogël por gjithnjë në rritje i është përvësuar studimit nëpër universitete të ndryshme të Zvicrës. Supozohet të ketë afro njëmijë studentë shqiptarë që studiojnë nëpër shkollat e larta e universitetet e ndryshme të këtij vendi (Burimi: LAPSH-i). Po ta marrim edhe thjeshtë nga aspekti islam, vërehet rritja e numrit të të rinjve të cilët gjithnjë e më shumë e vizitojnë xhaminë gjatë namazeve ditore e javore, interesimi i tyre për literaturë islame si dhe ngjallja e vetëdijes për identitetin e tyre fetar. Kjo mbase është edhe një sfidë që vjen nga kontaktet e përditshme me moshatarë të feve e kulturave të tjera. Ka edhe të rinj që për fat të keq kanë devijuar nga vlerat tona autoktone dhe janë zhytur në vese të këqija, mirëpo këta janë të paktë dhe ne e shohim si detyrë tonën të përbashkët - xhami, familje, shoqëri - mënjanimin e tyre prej kësaj gjendjeje dhe ofrimit e mundësisë për vetëdijesim.

AMC Press: Mësoni edhe fëmijët mërgimtarë në fenë islame, si qëndron puna me ata fëmijë në gjuhën amtare, e kam fjalën, e flasin mirë gjuhën shqipe?

R. Neziri: Nëpër klasat e veçanta (mektebet) që gjenden nëpër xhamitë tona këtu në Zvicër zhvillohet mësimi fetar për fëmijë e të rritur. Mësimi fetar për fëmijët prej klasës së parë e deri më të nëntën në xhaminë tonë, p.sh., zhvillohet tri ditë në javë: të mërkurën pas dite dhe të shtunën e të dielën para dite. Fëmijët të cilët në familje flasin shqip janë më të favorshëm, akoma më të favorshëm janë ata fëmijë që e ndjekin mësimin plotësisht të gjuhës amtare shqipe. Ata përpos që flasin mirë ose më mirë shqip, ata janë edhe më të suksesshëm si në shkollë publike ashtu edhe në mekteb. Andaj apeli im si imam drejtuar prindërve shqiptarë muslimanë dhe jomuslimanë me këtë rast është: "Dërgoni fëmijët tuaj në shkollën shqipe, nëse doni që ata të jenë më të suksesshëm në shkollë, në xhami e kishë dhe në jetë".

AMC Press: Ju faleminderit i nderuar z. Neziri dhe ju dëshirojmë gjitha të mirat.

R. Neziri: Edhe unë ju falënderoj për nderin që më bëtë. Zoti ju dhëntë të gjitha të mirat!

Intervistoi: Dashnim Hebibi



mërgimtarët e lodhur deri në kockë e të cilat mjete plus kanë edhe karakter fetar, si sadakaja, zekati, kurbanet etj. E po të pyesësh se çfarë i kthejnë këto bashkësi islame të vendlindjes kësaj popullate shqiptare muslimane në mërgatë, përgjigja është kjo: "njoftim" se Ramazani fillon me këtë datë e përfundon me atë datë, madje disa herë dinë edhe të na hutojnë me datat e ndryshme të bajrameve; "kërkesë" për tubimin e sadekatul-fitrit dhe zekatit në muajin e Ramazanit dhe "grumbullimin" e mjeteve për therjen e kurbaneve... Secila prej tyre ka organin e vetë informativ, gazetë apo revistë qoftë, secila prej tyre ka librarinë e saj, mirëpo asnjë xhamie, e le të mos flasim për muslimanin shqiptar, asnjëherë nuk i ka rënë në dorë ndonjë nga këto mjete informacioni si një dhuratë nga ndonjëra prej këtyre bashkësive islame të vendlindjes. Një "kontribut" tjetër i tyre dhënë kësaj popullate është edhe nxitja e përcarjes dhe e urrejtjes në mesin e tyre përmes disa figurave që mbështeten mbi baza lokaliste, e jo mbi vlera të mirëfillta fetare, morale, kulturore e intelektuale... Zoti na dhëntë hajrin!

AMC Press: Ku më shumë bashkëpunoni me teologët tjerë?

dhe Prindërve Shqiptarë) në Kreuzlingen dhe të vetmen përkrahje dhënë kësaj shoqate, për shembull, e shoh në ofrimin e plan-programit dhe përgatitjen e teksteve për mësimin plotësues të gjuhës amtare shqipe nga qeveria e Republikës së Kosovës. Tamam të mos ishte edhe kjo. Për më tepër ose unë nuk jam i njoftuar ose nuk ekziston vërtetë. Do të kisha dashur të ndodhte e para.

AMC Press: Meqë numri i bashkatdhetarëve po rritet dita ditës në Zvicër, a mund të na njoftoni, se si është puna, që nëse një bashkatdhetar ndahet nga jeta dhe familja e tij dëshiron që ta varrosë në Zvicër, si është mundësia dhe a e lejon feja islame që të varrosët?

R. Neziri: Shikuar nga aspekti fetar nuk ka ndonjë pengesë që kufomat tona të varrosen edhe këtu në Zvicër, nëse për këtë ekzistojnë mundësitë. Ndër më kryesoret është disponimi i varrezave të veçanta për muslimanët, jo të përziera me ato të të tjerëve, pastaj varrezat të jenë të kthyer drejt të drejtës së Mekkes si dhe të ekzistojë vullneti i lirë i personit apo familjes së tij për një varrim këtu. Ndërkaq ajo që ka ndodhur dhe po ndodh sot e kësaj dite është se prej të rriturve askush nuk ka shfaqur dëshirën për varrim në Zvicër, të gjithë kërkojnë pushimin e eshtrave të tyre në